



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KABINETI

Njoftim Për Shtyp

Rasti: Rasti i përfimit të kontrollit të shoqërisë ProQuest Holdings LLC nga shoqëria
A-PQ Holdings LLC

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është protokolluar nga AK, shkresa me Nr.333 Prot., datë 23.05.2019 “Atairos Management L.P / ProQuest Holdings LLC, blerja e 28.84% të pjesëmarrjes në dhe me kontroll të përbashkët tek shoqëria ProQuest Holdings LLC, njoftim në përputhje me nenin 10 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003” për mbrojtjen e konkurrencës” i ndryshuar”, ku përfaqësuesi ligjor C’M’S Adonnino Ascoli & Cavasola Scamoni, ku jemi njoftuar në lidhje me transaksionin e kryer për blerjen nga shoqëria Atairos Group të (kuotave) të pjesëmarrjes në dhe me kontroll të përbashkët tek ProQuest Holdings LLC.

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse:

Referuar “Marrëveshje të blerjes së njesisë klasa A-1”më datë 10 maj 2019, palët në marrëveshje janë:

Pala blerëse:

A-PQ Holdings LLC, është një shoqëri/filial i zotëruar tërësisht nga Atairos Group dhe Cambridge Information Group, me qëllim përfundimin e transaksionit të blerjes jashtë vendit.

Atairos Group është një shoqëri e regjistruar sipas legjislacionit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës e përqendruar në mbështetjen e bizneseve drejt rritjes në një gamë më të gjerë industrish, të tilla si financa, teknologjia, media, telekomunikacioni, shërbimet e biznesit dhe argëtimit familjar.

Cambridge Information Group është një shoqëri e regjistruar sipas legjislacionit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe aksionare e shoqërisë target ProQuest Holdings LLC.

Pala shitëse:

Shitësi : Goldman Sachs Inc (GS) është një shoqëri e regjistruar sipas legjislacionit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës e cila aktualisht zotëron afërsisht 38.45% të aksioneve në shoqërinë target ProQuest Holdings LLC. Goldman Sachs Inc është një shoqëri bankare e cila ofron shërbime

bankare investimi, tregti dhe investimi kryesore dhe administrimi i asetëve dhe shërbimet e letrave me vlerë.

Shoqëria Target: ProQuest Holdings LLC, ku ProQuest LLC është shoqëria operuese, shoqëri e organizuar sipas legjislationit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Palët pjesëmarrëse në transaksion kanë lidhur “Marrëveshje të blerjes së njesisë klasa A-1” më datë 10 maj 2019.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Si pasojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.